

UDHËZIM
Nr. 5, datë 17.2.2017

MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN
EKONOMIKE DERI NË 6 PËR QIND

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 21, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të kreut IV, pika 2, të vendimit nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”,

UDHËZOJ:

1. Këshilli i Bashkisë ka të drejtë të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike për familjet që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit, duke përdorur deri në 6% nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike.

2. Mbi këtë fond mund të shtohen ose jo edhe fonde të buxhetit vendor.

3. Akordimi i fondit deri në 6 për qind do t'i shtohet çeljes faktike të çdo 2-mujori që transferohet për përfituesit e ndihmës ekonomike të përzgjedhura nga sistemi i pikëzimit.

4. Këshilli i Bashkisë miraton në fillim të vitit kriteret për familjet në nevojë që do të trajtohen me fondin deri në 6 për qind.

5. Familjet në nevojë do të përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar brenda tre muajve të fundit nëpërmjet regjistrat elektronik për ndihmë ekonomike dhe që nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit.

6. Familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike do të miratohen me vendim të Këshillit Bashkiak.

7. Për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duhet të jetë kryer paraprakisht vlerësimi social ekonomik në familje nga administratori shoqëror sipas shtojcës 2, të vendimit nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”.

8. Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki harton projektvendimin për familjet në nevojë nën juridiksionin e Bashkisë, në bazë të propozimeve dhe vlerësimeve social ekonomike të ardhura nga njësitë administrative, për trajtim me ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6 për qind.

9. Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki përllogarit fondin për mbulimin e familjeve në nevojë që do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar deri në 6 për qind dhe e dërgon për miratim në Këshillin e Bashkisë.

10. Masa e ndihmës ekonomike për familjet llogaritet sipas strukturës së familjes, përcaktuar në udhëzimin e ministrit përgjegjës për çështjet sociale “Për përllogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike”.

11. Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki grumbullon dhe përgatit informacione, statistika mbi numrin e familjeve përfituese të trajtuara sipas këtij udhëzimi dhe fondin e realizuar të cilat i dërgojnë pranë strukturave rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

12. Nuk mund të trajtohen në bazë të këtij udhëzimi:

a) familjet të cilat nuk kanë aplikuar për ndihmë ekonomike sipas vendimit nr. 955, datë 7.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”;

b) familjet të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike sipas vendimit nr. 955, datë 7.12.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”.

13. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 15 maj 2017.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Blendi Klosi

